

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i pergjithëshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit A.A, nga fshati ..., Komuna e ..., i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore ne Prizren PP.nr.2911/2014 të datës 12.05.2015, për shkak të veprës penale heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KP-ës, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së, për dhënien e urdhrin ndëshkimor me datë 25.01.2016, muarr këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.A, nga i ati I., i lindur më ..., në fshatin ..., Komuna e ..., ku edhe tani jeton , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datë 12.06.2014, në fshatin ..., Komuna e ..., saktësisht në objektin të cilin e shfrytëzon, heqë apo dëmton vulën zyrtare apo shenjën e ngjitur nga zyrtari i autorizuar, ose e hap sendin në të cilin ka qenë e vendosur vula apo shenja e tillë, në atë mënyrë që i pandehuri A.A, ka shfrytëzuar energjinë duke falsifikuar pllombat shtetërore të njehsorit elektrik, numëruesi i njehsorit është, manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrit në numëror,

- këso dore ka kryer veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KP-së.

- Andaj, gjykata me aplikimin e dispozitave të nenit 4, 41, 43 par. 1 pika 1.3, nenit 46, 73 të KPK-ës dhe neni 495 të KPPK-ës jep:

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

- **PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2911/2014 të datës 12.05.2015 ashtu që.

Të akuzuarit A.A, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 200 € (dyqindë) euro, të cilin denim i akuzuari duet të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të zavendesohet me dënim burgimi duke llogaritur për çdo 20 € një ditë burg.

E dëmtuara KEDS, Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontest të rregulltë civil.

I akuzuari obligohet që të paguajë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20,00 €, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate, i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2911/2014 të datës 12.05.2015 kundër të akuzuarit A.A, nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KP-së, dhe kërkesën për lëshimin e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetim se janë siguruar të dhëna të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale të cila i vihet në barë dhe janë plotësuar kushtet ligjore kon forme nenit 493 të KPPK-ës për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit të kërkesës të PTH-ës në Prizren për dhënien e urdhrin ndëshkimor konstatoi se ka të dhënat mjaftueshme të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor, andaj gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore dhe mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kjo gjykatë konsideron se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë në procesverbalin me nr...., të datës 11.07.2014, procesverbalin me nr...., të datës 13.06.2014, në procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr...., të datës 22.01.2014, në transaksionet e konsumatorit me nr...., të datës 01.01.2014 deri me datë 31.12.2014, në faturën me nr...., të datës 18.07.2014, kartela e konsumatorit ..., në foto dokumentacion, si dhe në shkresat e tjera të lëndës vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale të cila i vihet në barë.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale u muar në bazë të nenit 450 dhe 451 par. 1 të KPPK-ës.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike u muarë në bazë të nenit 463 par.1 të KPPK-es,

Me sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimit

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN P.nr.1023/2015 të datës 25.01.2016

**Procesmbajtësja
Naxhis Sharani**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Luan Berisha**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimin, në këtë gjykatë. Po qesë i pandehuri nuk ushtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.